

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNEN E MAMUSHES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-23-5792-5-2-1
Nr i brendshëm	626-23-013-5-2-1

Sa i përket tenderit për: “Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekës në objektin e ri të QKMF-s në KK Mamushë”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“LIMIT L&B” SH.P.K. & REHA EPOKSID SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Xheladin Hana nr. 20

(Adresa)

Prizren

20 000

(Vendi)

(Kodi postar)

044 502505

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Liman Asllani

029 242 213

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@limitlb.com

(Adresa elektronike)

31.07.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe stamë)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 09.06.2023
Data e hapjes së ofertave dt. **03.07.2023**
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 25.07.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së – Qëllimi

Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca

Neni 56 i LPP-së - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 i LPP-së - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 09.06.2023, kurse data e fundit për dorëzim të tenderëve dhe hapja e ofertave ka qenë me dt. 03.07.2023.

Kriter kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Me dt. 25.07.2023, përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku e ka rekomanduar për kontratë OE EKO TERM SHPK, si dhe na keni eliminuar neve duke e shënuar se tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm.

Arsyeja juaja për eliminim tonë, tani është si vijon :

Në dosje të tenderit në Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT(FTD) në nenin 13.2 është kërkuar që:

Tenderuesit me tenderin e tyre të dorëzojnë sigurinë e tenderit me vlerë prej 1.000,00 € të vlefshëm për 90 ditë .

Ju keni dorëzuar sigurinë e tenderit në vlerë prej 1.000,00 euro, mirëpo keni dorëzuar vlefshmërinë për 89 ditë. Andaj nuk është plotësuar kërkesa e cekur më lartë.

Llëshimi i cekur më lart ka bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.

Fillimisht ju sqarojmë se arsyet e eliminimit janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe janë në kundërshtim të plotë me faktet dhe dëshmitë e ofruara nga ne.

Pretendimet tona ankimore ndaj arsyesimit tuaj do ti sqarojmë ne vazhdim:

Sa i përket arsyes së eliminimit se ne kemi ofruar sigurimin e tenderit me vlere prej 1.000,00 eurove per 89 dite, dhe jo per 90 dite siq eshte kërkuar ne dosje te tenderit eshte i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar.

Ju sqarojmë se ne kemi ofruar sigurimin e tenderit per 90 dite ashtu siq edhe eshte kërkuar ne kete aktivitet te prokurimit, e siq kërkohej ne shumicën e rasteve.

Nëse e analizoni sakt sigurimin e tenderit e shikoni se dt. e fillimit te sigurimit eshte 03.07.2023 dhe mbaron me dt 30.09.2023 qe i bije sakt 90 dite dhe ne përputhje me kërkesën e dosjes se tenderit.) 221 dite ne mujain KORRIK , 31 DITE NE MUAJIN gusht dhe 30 dite ne muajin SHTATORE , pra gjithsej 0- DITE.)

Pra siq e kemi dëshmuar dhe po e saktesojm se arsyeja juaj per eliminim tone eshte e pa bazuar dhe nuk përkon me faktet e ofruara nga ne.

Pas qasjes ne dokumentet e OE te rekomanduar per kontrate, kemi vërejtur se ju keni rekomanduar per kontrate nje OE te pa përgjegjshëm e per te cilin do te sqarojmë si me posht:

OE i rekomanduar per kontrate nuk e plotëson kërkesën tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1& 9.2 ku kërkesë ka qene: *1. Operatori ekonomik , duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për pune të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, së paku 45,000.00€.* dëshmi e kërkuar dokumentare: *Lista e projekteve të realizuara për punë të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me “Referencë” ose “Raport” për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës(transaksioni bankar fatura etj).*

OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar disa dëshmi per disa projekte te realizuar por qe nuk kan te bëjnë me natyrën e kontratës ose pune te ngjashme. Ne listën e projekteve te realizuar nga OE i rekomanduar per kontrate vërehet se nuk ka përfunduar asnjë projekt me “Shtruarje e dyshemesë me **epoksid**” dhe kjo e bene te qarte faktin se ky OE nuk ka punuar asnjëherë nje pune te till. Dihet qarte fakti se ju si autoritet keni kërkuar saktësisht bazuar edhe ne titullin e kontratës qe punimi kryesor duhet te jete me Epoksid, gjë qe OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka ofruar asnjë dëshmi qe ka punuar me këtë material te dyshemesë. Nisur nga ky fakt vërehet qartë dhe dëshmohet se OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotësin kërkesën e lartcekur dhe se nuk e përmbush ne tansi kërkesat e FDT-se dhe dosjes se tenderit dhe si i tillë duhet te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit sepse është OE i pa përgjegjshëm.

Ne konsiderojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në sipas nenit 59 të Ligjit Për Prokurim Publik sepse jemi eliminuar në mënyrë të kundërligjshme dhe duke u diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 Ligjit Për Prokurim Publik sepse jemi eliminuar edhe pse i kemi përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjersa ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe jemi ofertues më të lirë atëherë nga këto dëshmi konkrete kuptohet se nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që është tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, pra nuk është respektuar edhe një dispozitë e Ligjit Për Prokurim Publik e kjo dispozitë është neni 60 paragrafi 1.1 i këtij Ligji.

Gjithashtu ju si autoritet kontraktues nuk e keni pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa ju në këtë rast keni vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Si përfundim kërkojmë nga ju që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **“LIMIT L&B” SH.P.K. & REHA EPOKSID shpk**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Tani nuk i kemi të llogaritura dëmet e mundshme

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*